



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Rektori i përkohshëm  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 168  
Dt 25.02.2015

Në mbështetje të nenit 49 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Përkohshëm duke vendosur lidhur me kërkesat dhe statusin e studentëve të FGJT dhe FSHA, në mbledhjen e mbajtur më 16.2.2015, mori:

### Vendim

1. Lejohet transferimi i studentëve nga Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Universitetit të Prishtinës në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të Universitetit të Mitrovicës.
2. Studentët e transferuar do të futen në programin e SEMS-it të Universitetit të Mitrovicës dhe në këtë mënyrë kalojnë nga studimet me index në studime me ID kartë.
3. Në bazë të këtij vendimi, Fakultetet përkatëse do të lëshojnë vendime individuale për secilin nga studentët e transferuar, të cilat do të bëhen pjesë përbërëse e dosjes së secilit student.
4. Vendimi zbatohet edhe për studentët e nivelit master të këtyre fakulteteve.
5. Në bazë të vendimit të lëshuar, verifikimin lidhur me transferimin e notave do ta bëjnë prodekanët e njësive akademike të UMIB-it.

### Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës është në vitin e dytë të ekzistimit dhe të regjistrimit të studentëve në kuadër të tri fakulteteve teknike (FGJ, FTU dhe FIMK) kurse dy njësitë akademike të UP-së në Mitrovicë FGJT dhe FSHA janë duke e zhvilluar vitin e fundit të studimeve të rregullta në nivelin bachelor dhe master. Andaj, në pamundësi për të vazhduar studimet në kuadër të njësive akademike FGJT dhe FSHA të UP-së, Senati i Universitetit lejon transferimin e studentëve në programet përkatëse të fakulteteve teknike të Universitetit të Mitrovicës. Studentëve të lejuar për transferim do tu mundësohet futja në programin e SEMS-it të UMIB-it nga studimet me indeks në studime me ID kartë. Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve teknike të UMIB-it;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Sektorit të IT-së së UMIB-it;
5. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i përkohshëm